



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____.____.2025

Akt – Marrëveshje

“Mbi arkëtimin e tarifës së parkimit publik me pagesë”

Lidhur midis:

-Bashkia Elbasan, përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Gledian Llatja, më poshtë referuar si “Bashkia”,
-Subjektit _____, subjekt tregtar, rregjistruar në QKB me NIPT _____, përfaqësuar nga administratori/pronari i subjektit _____, më poshtë referuar si “Subjekti”

Konsiderata paraprake

- Duke qenë se Bashkia Elbasan, nëpërmjet sistemit E-Parking ka organizuar administrimin e parkimit publik me pagesë në zonat e përcaktuara prej saj dhe pagesën e tarifës orare të parkimit nëpërmjet këtij sistemi, duke synuar që t’ia lehtësojë procedurat qytetarëve apo subjekteve që do të shfrytëzojnë parkimin me pagesë orare;
- Duke qenë se Bashkia ka kërkuar bashkëpunimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e tyre në apo afër zonave të parkimit me pagesë për të vepruar si agentë tatimorë për mbledhjen e kësaj tarife dhe për këtë qëllim Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 76 datë 30.07.2024, ka vendosur që subjektet që do të kryejnë këtë shërbim do të përfitojnë shpërbllim në masën 5% të shumave të arkëtuara;
- Duke qenë se subjekti _____ është ofruar dhe është i interesuar të kryejë këtë shërbim,

Palët bien dakort sa vijon:

Neni 1

Qëllimi dhe objekti i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si qëllim rregullimin e të drejtave dhe detyrimeve të palëve në procesin e realizimit të objektit të marrëveshjes që është vjelja dhe arkëtimi i tarifave të parkimit publik në zonat dhe rrugët e paracaktuara për parkim me pagesë orare.

Neni 2

Detyrimet e Palëve

Bashkia Elbasan merr përsipër:

- Të pajisë subjektin me qasjen në sistemin web-based recharge.elbasani.gov.al për rimbushjen me kredite të përdoruesve mobile.
 - Të përcaktojë tarifën orare të parkimit me pagesë dhe të informojë për këtë subjektin sa herë që ajo ndryshon.
 - Të transferojë në llogarinë e subjektit shumat prej 5% të shumave të arkëtuara nga subjekti, si komision për shërbimin e kryer.
-

-Subjekti _____ merr përsipër:

- Nëpërmjet paisjeve të tij dhe në ambjentet e aktivitetit të tij, të kryejë rimbushjen me kredite në aplikacionin e konsumatorit, nëpërmjet sistemit në adresën recharge.elbasani.gov.al.
- Të transferojë në llogarinë e Bashkisë shumat e arkëtuara nga rimbushjet me kredite nga konsumatorët.

-Të informojë Bashkinë periodikisht për arkëtimet e kryera.
-Të vendosë në dispozicion të Bashkisë një numër kontakti (_____) dhe adresën e e-mail (_____), në të cilin do t'i dërgohen username dhe password për qasjen në recharge.elbasani.gov.al.

Neni 3 Rakordimet

Çdo 15 ditë, palët do të bëjnë rakordime ndërmjet tyre për pagesat dhe arkëtimet e tyre, si dhe shumën 5% që do t'i kthehet subjektit.

Arkëtimet e shumave do të derdhen në llogarinë e thesarit të Bashkisë Elbasan, pranë çdo banke të nivelit të dytë në të dhënat si më poshtë:

Kodi i Institucionit: 2109001

Kodi i Degës së Thesarit: 0808

Kodi i Parkimit: 7111007

Nëse subjekti, nuk transferon në llogaritë e Bashkisë shumat e arkëtuara nga rimbushjet me kredite nga konsumatorët, sikurse është parashikuar në paragrafin e mësipërm dhe në nenin 2 të marrëveshjes, Bashkisë i lind e drejta të përdorë procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimeve të parashikuara në dispozitat e ligjit 9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në R.SH." ndaj subjektit, për të siguruar arkëtimin e shumave.

Neni 4 Konfidencialiteti

Palët bien dakort dhe deklarojnë se do të përdorin në kushtet e konfidencialitetit, të dhënat e secilit, për të cilat kanë ardhur në dijeni për shkak dhe në zbatim të kësaj marrëveshje, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5 Afati

Kjo marrëveshje lidhet për një afat një vjeçar, me të drejtën e ripërsëritjes, sipas nevojës dhe marrëveshjes ndërmjet palëve, afat i cili fillon ditën e nënshkrimit të kësaj marrëveshje nga palët

Neni 6 Zgjidhja e marrëveshjes

Secila palë mund të tërhiqet nga marrëveshja, duke njoftuar palën tjetër jo më vonë se një muaj përpara datës së zgjidhjes.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pas nënshkrimit nga të dy palët.

Administratori/Pronari

**BASHKIA ELBASAN
Kryetari
Gledian Llatja**

**ME URDHËR E POROSI
Zv/Kryetare
Klaudia Krasnika**